

L I G J
Nr. 8159, datë 7.11.1996

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1632, DATË 1.11.1996 “PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN DHE
MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE
TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1632, datë 1.11.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” si vijon:

1- Paragrafi i dytë i nenit 1 të dekretit riformulohet:

“Personat fizikë dhe juridikë, shqiptarë dhe të huaj ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.”

2- Paragrafi i dytë i nenit 2 të dekretit riformulohet:

“Personat fizikë a juridikë, shqiptarë ose të huaj kanë të drejtë të blejnë truall, të tjetërsojnë këtë të drejtë të tretëve dhe të marrin me qera truall në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.”

3- Pika “2” e nenit 3 të dekretit riformulohet:

“2. Dhënia me qira e pronës shtetërore bëhet nga Ministria e Privatizimit.”

4- Neni 4 i dekretit riformulohet:

“Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Kalimi i pronës shtetërore në pronë private bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të privatizimit si, shitjes së saj me ankand, transferimit masiv të aksioneve, transferimit të një pakete të aksioneve personave fizikë a juridikë si dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

Vlerësimi i pronës shtetërore për qëllime orientuese në privatizim do të bëhet në bazë të akteve nënligjore të dala nga Këshilli i Ministrave.”

5- Neni 5 i dekretit riformulohet:

“Neni 25 ndryshohet si vijon:

“Agjencia Kombëtare e Privatizimit varet nga Këshilli i Ministrave. Ajo është i vetmi organ, që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe shprehimisht në ligj.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1642, datë 19.11.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha